



Data 18/02/2013

NJOFTIM PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR PARAQITJEN E KËRKESAVE

Ndërmarrja Shoqërore Kombinati Xehtarë – Metalurgjik Kimik “Trepça”

Bazuar në Aktvendimin AC-I-12-0131 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS) të nxjerrë sipas nenit 42 të Ligjit Nr. 04/L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurive të Tyre (tani e tutje “Ligji për Riorganizimin”) dhe duke vepruar sipas kushteve të nenit 43 të Ligjit për Riorganizimin, në lidhje me Vendimin e DHPGJS Nr. SCR-05-001-R008, R009 dhe R011, i datës 19.05.2011, dhe Njoftimin për Moratorium i publikuar më 8 nëntor 2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit (tani e tutje “Agjencia”) publikon Njoftimin për shtyrjen e afatit për paraqitjen e kërkesave në lidhje me Ndërmarrjen Kombinati Xehtarë – Metalurgjik Kimik “Trepça” (tani e tutje “Ndërmarrja”) – si ndërmarrje themelore si dhe ndërmarrjet tjera që identifikohen me kompleksin Trepça:

- A. **Shtyhet afati për paraqitjen e kërkesave të kreditorëve apo kërkesave të Interesit sipas Aktvendimit AC-I-12-0131, deri më datën 01 nëntor 2013.**
- B. Efektive nga 8 nëntori 2011, siç specifikohet në Njoftimin e Moratoriumit të publikuar, Agjencia duhet të shërbejë si Administrator i ndërmarrjes dhe të gjitha veprimet, procedurat dhe aktet e çfarëdo lloji që synojnë në përcaktimin e vlefshmërisë së, zbatimit ose kënaqjes së çfarëdo kërkesë ose interesi lidhur me ndërmarrjen e përmendur në Njoftimin për Moratorium, ose Pasurive të Tyre janë suspenduar dhe duhet të vazhdojnë vetëm me lejen e DHPGJS.
- C. Në përputhje me nenin 43 të Ligjit për Riorganizimin, Agjencia publikon këtë Njoftim për shtyrjen e afatit për dorëzimin e kërkesave duke informuar të gjithë të interesuari se ky afat do të rishpallet në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Riorganizimin dhe në përputhje me afatin e dhënë në Aktvendimin e DHPGJS.
- D. Njoftohen të gjithë kreditorët se kërkesat e tyre të parashtruara me kohë do të konsiderohen si kërkesa të parashtruara me kohë dhe se kreditorët mund t’i plotësojnë kërkesat e mëhershme. Të gjitha kërkesat e paraqitura nga kreditorët, pretenduesit të çfarëdo natyre kundër ndërmarrjes e të cilat janë regjistruar brenda afatit të dhënë më 01 nëntor 2012, konsiderohen të parashtruara me kohë dhe nuk kërkohet ri-aplikim por kreditorët kanë të drejtë t’i plotësojnë kërkesat e tyre themelore të paraqitura në afatin e parë.
- E. Agjencia, me 31 tetor 2013, do të rishpallë afatin për dorëzimin e kërkesave dhe pretendimeve kreditore apo pronësore ndaj ndërmarrjes Trepça. Ky njoftim do të bëhet në përputhje me nenin 17 të ligjit duke përkrahur detajet për mënyrën dhe vendin e parashtrimit të kërkesave, afatin brenda të cilit mund të parashtrohen dhe informata tjera me rëndësi për palët.